



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:224320

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06433138

C. nr. 2024:224321

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, si Gjykatë civile në shkallë të parë, gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, duke vendosur në çështjen civile kontestimore të paditësit **Z. (I.) A.** me vendbanim në Kaçanik, rruga "...", e identifikuar me letërnjoftim numër personal ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Sh. C., avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurve **N. (I.) T.** me vendbanim ne Kaçanik, rruga "...", **B. (I.) B.**, me vendbanim ne Kaçanik, rruga "...", **Z. (I.) B.**, me vendbanim ne fshatin ..., komuna Kaçanik, **I. (I.) B.**, me vendbanim ne Kaçani, rruga " ..." dhe **M. (I.) Sh.** me vendbanim ne Kaçanik, rruga "...", për çështjen kontestuese Vërtetimin e pronësisë, jashtë seance më datë 11.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të pohimit)

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditëses **Z. A.** nga Kaçanik, rruga "...", në tërësi si e bazuar dhe **VËRTETOHET** se paditësja **Z. A.** është pronare e paluajtshmerive edhe atë:

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur "...", me sipërfaqe prej 17086 m², mal i klasës 4, pjese e pronës 1/3

- njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur "...", me sipërfaqe prej 10356 m², are e klasës 8, pjese e pronës 1/2

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur “...” me sipërfaqe prej 1255 m², livadh i klasës 8, pjese e pronës 1/1

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur “...” me sipërfaqe prej 3625 m², livadh i klasës 8, pjese e pronës ½

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur “...” me sipërfaqe prej 1504 m², kullose e klasës 5, infrastruktura prone private, toke ndërtimore shtëpi-ndërtesë/ toke ndërtimore oborr, pjese e pronës 1/1

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur “...” me sipërfaqe prej 3903 m², pemishte e klasës 5, pjese e pronës 1/1

-njësia kadastrale ... Komuna Kaçanik/ ZK Gjurgjedel vendi i quajtur “...” me sipërfaqe prej 8443 m², are e klasës 7, pjese e pronës ½, të evidentuara sipas certifikatës pronësore me nr. ..., në emër të të ndjerës **Z. Bela**.

II.DETYROHEN, të paditurit të lejojnë që paditësja në bazë të këtij vendimi të regjistrojnë pronësinë në librat përkatëse pronësore pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Kaçanik.

III.Konstatohet se pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore në emër të taksës për padi në shumë prej 20€.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 14.08.2024, përmes së autorizuarit të tij, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ka theksuar se paditësja është poseduese faktike e paluajtshmerive të cekura me larte, të cilat evidentohen në emër të paraardhëses të te paditurve Z. B. , sipas certifikatës pronësore me nr. ..., në emër të të ndjerës F. J. .

Paditësja, paluajtshmërit kontestuese i posedon qetë dhe pa pengesa apo pretendime nga ana e askujt përfshirë edhe të paditurit pas marrëveshjes gojore ne vitin 1980 me paraardhësin e te paditurve për shitblerjen e ngastrave lëndore, ku ne njëhën prej parcelave ka te ndërtuar edhe shtëpinë ku edhe sot jeton me familjen e saj, dhe pas përmbushjes se detyrimeve ndërmjet palëve ndergjyqese, paditësja ka interes juridik qe kjo shitblerje te legalizohet, meqë këto ngastra evidentohen ne emër te paraardhësit te te paditurve, e ne rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore te parapara ne nenin 73 te LMS-se, gazeta zyrtare RSFJ-se nr. 29/78, konkretisht edhe dispozita 282 e LPSD-se.

Gjithashtu ka shtuar se paditësja pronësinë e ka fituar edhe ne baze te mbajtjes, pasi qe nga viti 1980 këto paluajtshmeri vazhdimisht dhe pas asnjë ndërprerje i ka ne posedim me mirëbesim, andaj pasi kane kaluar me shume se 20 vite, paditësja e ka fituar pronësinë ne baze te nenit 40 te LPDS-se.

Tutje ka theksuar se paditësja është poseduese e ndërgjegjshme dhe e ligjshme, pasi është me mirëbesim ku mirëbesimi vërtetohet nga fakti se këto pajujtshmeri janë blere me kontrate interne e cila blerje nuk është kundërshtuar nga te paditurit, gjithashtu edhe nga fakti se ne këtë paluajtshmeri pala paditëse e ka ndërtuar objektin e banimit dhe përsëri nuk është penguar apo kundërshtuar nga askush.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Të paditurit N. T., B. B., Z. B., I. B. dhe M. Sh., në përgjigje në padi, të cilën e kanë paraqitur gjykatës të nënshkruar personalisht, kanë deklaruar një zëri se nuk e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditëses, të njëjtën kërkesë padi e pranoj si të bazuar mbi faktet e shënuara si në padi.

Kanë theksuar se: *“konfirmojmë se ndërmjet neve si pale ndergjyqese nuk është kontestuese gjendja faktike e si rrjedhoje deklarojmë se e pohojmë kërkesëpadinë ne tërësi si dhe faktet vendimtare ne te, qe nënkupton pranimin e pasojave juridike qe i kërkon pala paditëse.”*

Gjithashtu kane deklaruar se ne te paditurit si pasardhës/trashëgimtar te vetëm te paraardhës/trashëgimlënëses respektivisht pronare e paluajtshmerive, pranojmë qe paluajtshmerite e cekura si ne padi ti kalohen ne pronësi paditëses.”

Gjithashtu kanë propozuar që gjykata të merr aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore dhe po ashtu kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës.

Gjykata në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Certifikata Pronësore me nr...., lëshuar nga Zyra Kadastrale, Komuna Kaçanik, vërteton se pasuria e paluajtshme objekt kontesti, evidentohet në emër të të ndjerës Z. B. , dëshmi vdekja për të ndjerën Z. B. , Certifikata e vdekjes nr. ref. 7... për Z. B. , Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ... për Z. A. Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për N. T., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ., për B. B., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për Z. B., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për I. B., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për M. She., vërtetoi dhe konstatoi se të paditurit janë trashëgimtarët-pasardhësit e të ndjerës Z. B. , në emër të të cilës evidentohen këto prona, e që për arsyeje të pa njohura nuk e kanë bere bartjen e pronësisë, kurse paditësja vazhdon që të ketë interes juridik për përcaktimin e statusit juridik të pasurisë së paluajtshme e që është në posedim të tij për këtë fakt nuk e kanë mohuar edhe të paditurit në bazë të përgjigjes në padi, me çka gjykata është bindur se nuk ka kontest pronësor në lidhje me këtë çështje.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve me anë të përgjigjes në padi vlerësoi se pohimi i të paditurve është bërë me vullnet të lirë të pa penguar, i nënshkruar nga të paditurit, njëherit konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”* – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe po ashtu sipas nenit 398 par.1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* (Aktgjykim pa seancë gjyqësore). Gjykata vendosi jashtë seancës lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata konstatoi se pala paditëse e ka paguar taksën për padi në lartësi prej 20€ e cila është në harmoni me vlerën e objektit të kontestit.

Nga sa u tha konform nenit 148 dhe nenit 398 te LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK

C.nr. 2024:224321 datë 11.11.2024.

Gjyqtari:
Burhan BERISHA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkakun se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.